

## Nazmi (Ramadan) Gashi

(9.04.1978, shqiptar nga Komarani/Komorane, komuna e Glogocit/Glogovac, punëtor, pjesëtar i UÇK-së)

## Rizah (Sokol) Salihaj

(3.05.1978, shqiptar nga Zabërgja/Zabrde, komuna e Klinës/Klina, punëtor ndërtimeor, pjesëtar i UÇK-së)

Xhevdeti dhe Shefqeti e kanë braktisur Kosovën dhe kanë shkuar në Gjermani për shkak të problemeve me policinë serbe. Xhevdeti u kthye në vitin 1996. Aderoi zyrtarisht në UÇK në muajin prill të vitit 1998, edhe pse përpara kësaj date ka marr pjesë në bartjen e armatimeve nga Shqipëria në Kosovë. E quanin Komandant Gje-biri. Shefqeti u kthye nga Gjermania në verë të vitit 1998. Shkoi në Shqipëri, ku u bë pjesëtar i UÇK-së.

Pas përfundimit të shkollës së mesme, Nazmi (Ramadan) Gashi ka punuar për një kohë në Slloveni. U kthye në muajin dhjetor të vitit 1997. Në muajin shkurt të vitit 1998, policia e kishte plagosur atë, përderisa shkonte në varrimin e vëllezërve Ahmeti në Likoshan/Likošane [të shikohet regjistrimi në faqen 84]. U inkuadrua në UÇK në pranverë të vitit 1998. Daja i tij Sylka, para aderimit në UÇK, punonte në Gjermani. Xhaferi u bë anëtar i UÇK-së në muajin mars, ndërsa Nazmi (Nebih) Gashi në fillim të muajit maj të vitit 1998.

Në datën 27.08.1998, nga ora 23:00, Xhevdeti, Shefqeti, Sylka me nipin Nazmiun, Xhaferi, Nazmi (Nebih) Gashi dhe Rizahu, në përbërje të grupit prej 250 ushtarësh të UÇK-së, nga territori i Shqipërisë e kaluan kufirin me Kosovën te vendi i quajtur *Rrasa e Zogut/Ptičiji kamen* [**Koshare/Košare**]. Disa orë më vonë [28.08.1998], kanë rënë në pritë të forcave serbe. Shefqetin e kanë qëlluar për vdekje menjëherë gjatë shkëmbimit të parë të zjarrit në mes të dy forcave. Të tjerë u ndanë në dy grupe. Xhevdeti, Sylka, Xhaferi me nipin Nazmiun, Nazmi (Nebih) Gashi dhe Rizahu ishin në përbërje të grupit që u nis drejt Jasiqit/Jasić. Pas disa orësh, ky grup sërish ka hasur në forcat serbe. Xhevdeti, Xhaferi, Nazmi (Nebih) Gashi dhe Rizahu u vranë gjatë betejës. Sylka dhe nipi i tij Nazmiu u pla-

gosën. Nga frika se do të binin të gjallë në duart e forcave serbe, ata vet e aktivizuan një granatë dore, nga e cila gjetën vdekjen.

Trupat e Sylës, nipit Nazmiut, Xhevdetit, Shefqetit, Xhaferit dhe Nazmi (Nebih) Gashit, forcat serbe i çuan në Gjakovë/Dakovica. Punëtorët e ndërmarrjes komunale *Çabrat/Čabrat* i kanë varrosur në varrezat e qytetit. Pas përfundimit të luftës, familjarët i kanë zhvarrosur varret e tyre dhe i kanë identifikuar trupat në bazë të rrobave dhe dokumenteve personale. Shefqeti, Xhaferi dhe Nazmi (Nebih) Gashi janë rivarrosur në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në Grabanicë/Grabanica. Xhevdeti u rivarros në varrezat e Cërmjanit/Crmljane, Sylka në varrezat e Gjergjicës/Đurdica, ndërkaq Nazmi (Ramadan) Gashi në Komaran/Komorane.

Nga mesi i janarit të vitit 2004, familjarët e Rizës u ftuan nga Zyra e UNMIK-ut për Persona të Zhdukur t'i merrnin mbetjet mortore të Rizës, që ishin gjetur në varrezat në Junik në vitin 2002. Mbetjet mortore të Rizës u varrosën në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në Grabanicë/Grabanica, më 25.01.2004.

**Burimet:** deklarata Z.P, FDH-29019; deklarata S.S, FDH-31823; deklarata R.G, FDH-29785; deklarata H.B, FDH-33565; deklarata B.Sh, FDH-33367; deklarata Z.H, FDH-30765; deklarata N.G, FDH-30708; deklarata S.G, FDH-30763; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092.

## Fane (Bajram Vishaj) Çallakaj

(1.05.1943, shqiptare nga Baballoqi/Babaloc, komuna e Deçanit/Dečani, amvise, gjashtë fëmijë)

## Shqipe (Avdyl) Çallakaj

(1974, shqiptare nga Baballoqi/Babaloc, komuna e Deçanit/Dečani, e papunë, e pamartuar)

## Xufe (Avdyl) Çallakaj

(1982, shqiptare nga Baballoqi/Babaloc, komuna e Deçanit/Dečani, nxënëse)

Shqipe me të vëllain Muhametin dhe familjen e tij e kanë braktisur Baballoqin/Babaloc më 12. 08.1998. I ka strehuar Haxhi Molukaj nga fshati Lumbardh/Ljumbarda [Deçan/Dečani]. Një ditë më vonë, atyre iu bashkëngjitën nëna Fane dhe motra Xufe.